



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 185 Prot.

Kamëz, më 18.12.2020

V E N D I M

Nr. 185 PËR

“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR TRAJTIMIN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA FONDET E BUXHETIT BASHKISË PËR VITIN 2021”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **18.12.2020** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.148 Datë 14.12.2020**, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 21 të Ligjit nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë, Kreut IV, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Minsitrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, dhe VKB nr. 85, datë 17.07.2020 “Për miratimin e limiteve të PBA për vitet 2021, 2022, 2023
Këshilli Bashkiak Kamëz :

V E N D O S I :

1. Miratimin e kriterëve për trajtimin me Ndihmë Ekonomike të familjeve në nevojë nga fondet e buxhetit lokal si më poshtë vijon:
 - a. Familje me fëmijë jetim.
 - b. Familje që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme.
 - c. Të moshuar që janë të vetmuar dhe pa kujdestari.
 - d. Familje me persona invalid dhe kushte shumë të vështira/ pa të ardhura të tjera.
 - e. Familje me kryefamiljarë në burg dhe fëmijë të vegjël.
 - f. Gra me problem dhune në familje.
 - g. Familje që kanë probleme të mëdha shëndetësore dhe kërkojnë ndërhyrje të rënda kirurgjikale si dhe operime jashtë shtetit etj.
 - h. Familje që janë prekur nga fatkeqësi njerëzore dhe natyrore.
 - i. Familje që nuk kanë banesë të tyre dhe janë pa të ardhura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Në këtë skemë do të përfshihen familjet që verifikohen për situatën ekonomike nga grupi i punës i drejtorisë së ndihmës ekonomike në bashkëpunim me komisionin e Këshillit Bashkiak. Masa e përfitimit do jetë sipas rasteve, në konsultim me titullarin e institucionit dhe komisionin e ekonomisë të KB, bazuar në fondin e vënë në dispozicion.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETARE
MERITA PRENGA

